

Interreg



ADRION

ADRIATIC-IONIAN

European Regional Development Fund - Instrument for Pre-Accession II Fund

POWER



UDHËZUES PËR THIRRJEN PËR ZGJIDHJE

PoWER Thirrje për Zgjidhje (C4S)

NENI 1 - HYRJE

PoWER është një Projekt Evropian (Interreg ADRION, 2018-2020); objektivi i tij është të mbështesë portet detare në një mënyrë që i shndërron ato në **Qendra Inovacioni** të afta për të riinterpretuar dhe përtëritur rolin e tyre historik të shkëmbimit të vendeve, për t'i bërë pika lidhëse ndërmjet konteksteve të ndryshme territoriale të Adriatikut dhe për të lehtësuar zgjerimin e potencialit të tyre sipërmarrës, i cili aktualisht është i pabaralizuar ose jo i vlerësuar në mënyrën e duhur. Nëpërmjet këtij evolucioni të porteve të Adriatikut përmes Qendrave të Inovacionit, PoWER synon të ndryshojë perspektivën e të parit të porteve kryesisht të karakterizuar nga organizimi strukturor i dobët, në një aspekt të fokusuar në përfaqësimin, modernizimin, zgjimin, pozicionimin socio-ekonomik, proceseve të rigjenerimit dhe veprimeve të rindërtimit të porteve.

Për të arritur këtë objektiv, PoWER lehtëson dhe inkurajon bashkëpunimin midis aktorëve kyç të zinxhirit të furnizimit të inovacionit: **institucionet arsimore** (shkollat e mesme dhe profesionale, universitetet, institucionet kërkimore), **kompanitë dhe autoritetet publike**. Ky lloj bashkëpunimi transformon probleme komplekse që ndikojnë në portet dhe kontekstet urbane përreth nëpërmjet mundësive të kërkimit dhe bashkëpunimit, krijimit të zinxhirëve të prodhimit dhe hapjes së tregjeve.

Në veçanti, PoWER fokusohet në temën "Energjia" (eficienca e energjisë, rizhvillimi i ndërtesave, energjia nga burimet e rinovueshme, etj.), duke e bërë energjinë një faktor strategjik në çdo plan zhvillimi të territorit / biznesit.

Gjatë kohëzgjatjes së projektit, do të zbatohen 6 projekte pilot në zonat e portit në Ravenna, Bari, Rijeka (HR), Igumenicë (GR), Brcko (BiH), Durrës (AL). Qëllimi i pilotimit është të demonstrojë efektivitetin e qasjes së adoptuar për mbështetjen e lindjeve të ideve dhe propozimeve për sipërmarrje, krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit për të dizenuar produkte / shërbime të reja, zhvillimi i rrjeteve që lehtësojnë hapjen e tregjeve të reja të bazuara në bashkëpunimin ndërmjet forcave më inovative të vendeve të ndryshme të përfshira në PoWER.

Në veçanti, PoWER parashikon disa veprime të lidhura ngushtë me këtë "Thirrje për Zgjidhje", sipas këtij rendi kronologjik:

- Krijimi i një **Liste të Nevojave** në lidhje me secilën prej 6 zonave pilot;
- Mbledhja e ideve dhe zgjidhjeve për nevojat e përmendura më parë: ky veprim do të kryhet, nga njëra anë, nëpërmjet "Thirrjes për Bashkëpunim" në objekt; nga ana tjetër, përmes zbatimit të 6 "Sesioneve të zgjidhjeve kreative" që përfshijnë studentët e shkollave të mesme, shkollave profesionale dhe universiteteve nga vendet pjesëmarrëse në PoWER;

· Një **rrugë bashkë-dizajnimi** synohet që në nisje të projektit, përmes përfshirjes së të gjithë aktorëve të interesuar dhe duke përdorur idetë / zgjidhjet e mbledhura gjatë fazës së vëzhgimit, të arrihet qëllimi i krijimit të 6 porteve "Qendra për Inovacionin e Energjisë".

NENI 2 - OBJEKTI I THIRRJES

Kjo thirrje për propozim promovohet në emrin e Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim në kuadër të projektit PoWER, dhe ka për qëllim zgjedhjen e produkteve dhe shërbimeve të lidhura me sektorin e energjisë të cilat janë të përshtatshme për çështjet e përshkruara në seksionin "Nevojat" në faqen tonë të internetit www.powerports.eu/sq/kerkese-per-bashkepunim Propozimet e dorëzuara mund të përpunohen në nivele të ndryshme:

- **Ide** që duhet të zhvillohen dhe të zhvillohen si prototipe;
- **Prototipa ose patenta** që do të tregtohen;
- **Produkte ose shërbime** tashmë në treg.

Në mënyrë që të aplikojnë, kandidatët duhet të plotësojnë një formular të dedikuar në faqen e internetit të PoWER C4S www.powerports.eu/sq/kerkese-per-bashkepunim dhe të përdorin formularët on-line të listuara në seksionin e www.powerports.eu/sq/kerkese-per-bashkepunim.

PoWER C4S nuk është një veprim tregtar. Ai synon të lehtësojë veprimet e rrjetëzimit midis kërkesës (përfaqësuar nga Autoritetet Portuale dhe Autoritetet Publike, në rastin konkret Porti i Durrësit dhe Autoriteti Portual Durrës) dhe ofertës (përfaqësuar nga kompanitë, organizatat kërkimore dhe arsimore).

Për më tepër, përfshirja në rrjetin PoWER i ofron kandidatëve mundësinë për të promovuar idenë e tyre / prototipin / produktin përmes platformës PoWER. Kjo platformë do të krijohet posaçërisht për menaxhimin dhe komunikimin e procesit të tranzicionit që transformon Portet në Qendra Inovacioni. Pas përfundimit të projektit, platforma gjithashtu do të lejojë pjesëmarrësit e C4S të luajnë një rol aktiv në ndërtimin e projekteve të ardhshme të lidhura me energjinë që nxiten nga rezultatet e veprimeve pilot të projektit PoWER.

NENI 3 - APLIKANTËT

Pjesëmarrja në PoWER C4S është pa pagesë dhe i drejtohet:

- Profesionistëve të pavarur;
- Kërkuesve shkencorë;
- Ndërmarrjeve e vogla dhe të mesme;
- Industrive.

Pjesëmarrësit duhet të kenë vendin e tyre ligjor ose selinë e tyre operacionale në një nga vendet partnere të PoWER, që janë Italia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Shqipëria

ose Greqia (shih seksionin www.powerports.eu/sq/kerkese-per-bashkepunim të websitit www.powerports.eu).

NENI 4 - SPECIFIKIME DHE KORNIZA OPERATIVE PËR PROPOZIME

Propozimet që do të dorëzohen në PoWER C4S mund të jenë:

- ide që duhet të zhvillohen dhe të zhvillohen si prototipe;
- Prototipet ose patentat që do të tregtohen;
- produkte ose shërbime që tashmë janë në treg.

Liria kreative jepet për sa kohë që propozimet trajtojnë problemet e theksuara në seksionin e dytë e faqes së internetit www.powerports.eu/sq/kerkese-per-bashkepunim.

NENI 5 - KUSHTET PËR PJESËMARRJE

Pjesëmarrësit në thirrjen për propozime të PoWER C4S duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për t'u kualifikuar:

4.1 PROFESIONISTËT E PAVARUR / NMV / INDUSTRI

- Ata kanë selinë e tyre ligjore ose selinë e tyre të operacionale në një nga partnerët e projektit PoËER (Italia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Shqipëria ose Greqia);
- Ata nuk janë në një pozicion falimentimi, ose në procedura falimentimi, asetet e tyre nuk janë të administruara nga likuiditor/përmbartimi apo gjykata, ata nuk janë në një marrëveshje me kreditorë apo në një situatë të ngjashme me sa u përshkrua më sipër të parashikuar nga legjislacioni shqiptar;
- Përfaqësuesit e tyre ligjorë, administratorët (me ose pa tagra përfaqësimi), ortakët e tyre, nuk kanë dënime penal, administrativ apo sipas parashikimit të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Nr.9901, datë 14.4.2008.

Kompanitë që nuk i përmbushin këto kritere do të përjashtohen nga thirrja për propozime.

4.2 KËRKUESIT

- Ata/ato veprojnë në një institucion kërkimor në një nga vendet partnere të projektit PoËER (Italia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Shqipëria ose Greqia);
- Ata/ato nuk janë dënuar dhe nuk kanë procedurë penale në progres.

Në fazën e aplikimit, aplikantët do të deklarojnë se përmbushin kërkesat për pjesëmarrje dhe të njohin, pranojnë dhe konsiderojnë të detyrueshme të gjitha rregullat e kësaj thirrjeje për propozime.

NENI 6 - REGJISTRIMI DHE RREGULLAT E PJESËMARRJES

Thirrja PoWER C4S për propozime është në shfaqur në faqen e internetit www.powerports.eu/sq/kerkese-per-bashkepunim. Për të marrë pjesë, aplikanti duhet të plotësojë një formular për paraqitjen e propozimit të bërë me dy seksione kryesore:

- Të dhënat e identifikimit të pjesëmarrësit dhe pranimi i rregullave / kërkesave të thirrjes (Rregullorja, vetë-vërtetimi i kërkesave, Politika e privatësisë së faqes së internetit, lejimi i përdorimit të materialeve të vëna në dispozicion);
- Përshkrimi i Propozimit (gjithashtu do të jetë e mundur të bashkëngjitni, nëse është e nevojshme, më tej foto dhe materiale relevante, video, etj. me qëllim që të ofrohet një pamje më e qartë e propozimit).

Pjesëmarrja në konkurset e tjera të biznesit nuk përbën pengesë për pranimin.

Çdo pjesëmarrës mund të dorëzojë maksimalisht 2 propozime për PoWER C4S, me kusht që ato t'i referohen dy nevojave të ndryshme të renditura në seksionin e www.powerports.eu/sq/kerkese-per-bashkepunim të faqes së internetit.

Të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të vërteta. Ato do të përpunohen sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/201. Promovuesit e thirrjes rezervojnë të drejtën për të mos pranuar propozime të cilat nuk janë në përputhje me objektivat dhe frymën e thirrjes.

Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë propozimin e tyre, që lidhet me zonën e treguar në nenin 3 të këtij dokumenti, duke u përqendruar në veçanti në aspektet e mëposhtme:

- **Titulli** i propozimit
- **Tipologjia**, gjerësisht specifikoni idenë / prototipin / produktin
- **Nevoja specifike** për të cilën propozimi jep një zgjidhje (specifikoni numrin e formularit "Nevoja" dhe kodin e letrës në lidhje me "nevojën specifike" siç tregohet në seksionin e www.powerports.eu/sq/kerkese-per-bashkepunim në faqen e internetit)
- **Përshkrimi i Propozimit** (do të jetë e mundur të bashkëngjitet propozimi deri në një maksimum prej 3 faqeve)
- **Cili është ndikimi social** që propozimi mund të arrijë.
- **Cili është ndikimi kulturor** që propozimi mund të arrijë.
- **Cili është ndikimi mjedisor** që propozimi mund të arrijë.

Në rast të një ideje për që kërkon krijimin e një patente, tregoni cilat **burime ekonomike janë të nevojshme** për realizimin e prototipit dhe me çfarë aranzhimesh financiare mund t'i mbuloni ato (nëse ka).

Në rastin e një patente që do të tregtohet, raportoni **cilat burime ekonomike janë të nevojshme** si për industrializimin e produktit / shërbimit (dhe me cilat marrëveshje financiare synoni t'i mbulojnë ato, nëse ka) dhe për zbatimin e produktit / shërbimit.

Në rastin e një produkti / shërbimi tashmë në treg raportoni kostot për blerjen dhe zbatimin.

- Koha e nevojshme që ideja e propozuar të bëhet plotësisht funksionale.

Një hapësirë specifike në formën e aplikimit do të rezervohet për një abstrakt të propozimit.

Propozimi mund të shkruhet në një nga gjuhët e vendeve pjesëmarrëse në PoWER.

Abstrakti duhet të shkruhet në të dyja gjuhët, në një prej gjuhëve të vendeve pjesëmarrëse në PoWER dhe në gjuhën angleze.

NENI 7 - KOHËZGJATJA DHE AFATET

Aplikantët duhet të dorëzojnë aplikacionet e tyre nga 14 Janar - 15 Shkurt 2019

Përzgjedhjet do të bëhen në nivel kombëtar përpara 28 Shkurt. Një maksimum prej 10 propozimesh do të përzgjidhen në secilin vend. Bordi i përzgjedhjes lokale do të publikojë në faqen e internetit listën e zgjidhjeve / patentave të përzgjedhura në www.powerports.eu/sq/kerkese-per-bashkepunim.

Zgjedhja rajonale do të zhvillohet përpara Prill 2019. Propozimet e përzgjedhura më parë në nivel lokal do të vlerësohen dhe midis tyre bordi i përzgjedhjes rajonalee do të zgjedhë një maksimum prej 20 propozimesh. Bordi i përzgjedhjes rajonale do të publikojë në faqen e internetit listën e 20 zgjidhjeve / patentave të fituara në Maj 2019.

NENI 8 - JURIA PËRZGJEDHËSE DHE PROCEDURAT

Juria e përzgjedhjes lokale do të përbëhet nga së paku 3 anëtarë, personalitete nga bizneset lokale, studiues dhe nga institucionet kulturore; anëtarët e jurisë së përzgjedhjes do të zgjidhen dhe emërohen nga partnerët e projektit. Juria e përzgjedhjes është përgjegjëse për analizën dhe vlerësimin e të gjitha propozimeve të paraqitura nga pjesëmarrësit, në përputhje me nenin 6 të këtij dokumenti, me qëllim përzgjedhjen e deri në 10 propozime.

Juria e përzgjedhjes rajonale do të përbëhet nga një anëtar nga secili partner i projektit (i zgjedhur sipas karakteristikave të listuara më sipër) dhe do të zgjedhë deri në 20 propozime. Vlerësimi i dy jurive është përfundimtar dhe i pakundërshtueshëm.

NENI 9 - KRITERET E PËRZGJEDHJES

Propozimet e paraqitura që plotësojnë kërkesat për thirrjen do të vlerësohen nga juria sipas kriterëve të paraqitura më poshtë.

Vlerësimi do të hartohet përmes një skeme të shkurtër të vlerësimit deri në 100 pikë të detajuara si më poshtë:

Artikulli vlerësohet	Pikët Maksimale
----------------------	-----------------

Rëndësia për sfidat energjetike të porteve që shfaqet në analizën e nevojave	30
Mundesia e ripërsëritjes së implementimit të zgjidhjes	20
Ndikimi social	5
Ndikimi kulturor	5
Ndikim mjedisor	5
Qëndrueshmëria ekonomike	15
Afati kohor për zbatimin	15
Qartësia dhe sinteza e propozimit	5
Pikët maksimale	100

NENI 10 - SHPËRBLIMI DHE VIZIBILITETI

Shpërblimi konsiston në shikueshmërinë e lartë të ofruar përmes projektit në kuadër të audiencës evropiane.

Propozimet e përzgjedhura në nivel lokal dhe rajonal do të kenë shanset e mëposhtme për vizibilitet:

- Do të përfshihen në bazën e të dhënave "Ide dhe zgjidhje" të platformës PoWER;

- Do të jenë të dukshme në nivel kombëtar dhe evropian falë pjesëmarrjes në eventet promovuese në nivelin lokal dhe ndërkombëtar (Rijeka dhe Novi Sad);
- Ata do të gjejnë mundësi konkrete zhvillimi përmes konkurseve, në përputhje me llojin e propozimit të paraqitur. Në mënyrë të veçantë:

Nëse propozimi konsiston në një ide	Mbështetje në identifikimin e organizatave publike dhe / ose private që udhëheqin në zhvillimin e patentës.
Nëse propozimi konsiston në ndërtimin e një prototipi ose një patente	Mbështetje në identifikimin e projekteve të aplikantëve dhe udhëzimeve në identifikimin e vendeve të përshtatshme promovuese për aplikantin brenda zonave të portit.
Nëse propozimi konsiston në një produkt/shërbim tashmë në treg	Shikueshmëria përmes platformës dhe eventeve të PoWER, me mundësinë e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në eventet lokale, kombëtare dhe evropiane, si dhe mundësinë e organizimit të takimeve të drejtpërdrejta me klientë të mundshëm.

NENI 11 - KUFIZIMET E PËRGJEGJËSIVE

Promovuesi nuk merr përgjegjësi për ndonjë vështirësi në procesin e aplikimit të shkaktuar nga dështimi teknik i faqes së internetit.

NENI 12 - GARANCITË

Aplikuesi, duke paraqitur kërkesën, garanton që përmbajtja e dorëzuar:

- Nuk përmban asnjë material që shkel të drejtat, pozitat apo pretendime të palëve të treta (duke iu referuar ligjit mbi të drejtën e autorit dhe pronësisë industriale dhe ligjeve dhe rregulloreve të tjera në fuqi në Republikën e Shqipërisë);
- Nuk përmban materiale të pahijshme, pornografike, të paligjshme, të ndaluara me ligj ose në kundërshtim me atë që tregohet në këtë rregullore;
- Përmbajtja është e lirë dhe e ligjshme në përdorim në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje sepse përdoruesi është pronar i të drejtave të përdorimit të tyre, ose që ka fituar disponueshmërinë nga të gjithë subjektet që kanë të drejtë, duke u kujdesur për pajtueshmërinë e plotë dhe / ose përmbushjen e të drejtave - madje edhe të natyrës ekonomike - për shkak të autorëve të përmbajtjes dhe / ose veprave nga të cilat këto përmbajtje rrjedhin dhe / ose nxirren, ose subjekteve të tjerë të titulluar sipas ligjit për Pronësinë Intelektuale të Republikës së Shqipërisë, ose për shkak të përdorimit të imazhit dhe të drejtave të emrit të parashikuara me ligj.

Kandidatët që marrin pjesë në Thirrjen për Zgjidhje janë të vetëdijshëm se përgjegjësitë, madje edhe kriminale, të përmbajtjes së paraqitur ose të bashkangjitur për qëllimin e pjesëmarrjes, i ngarkohen kandidatit që i ka upload-uar ato;

Kandidati merr përsipër të mbajë stafin e PoWER-it të padëmtuar nga dhe kundër çdo pretendimi, veprimi ose kërkesë duke përfshirë, por pa u kufizuar në, shpenzimet ligjore dhe të kontabilitetit që rrjedhin nga përmbajtja e ngarkuar ose materialet e tjera të ofruara për PoEER ose shkelja nga kandidatët e këtyre kushteve. Stafi i PoWER merr përsipër të njoftojë menjëherë kandidatin për çdo kërkesë, veprim ose procedim ligjor.

NENI 13 - BAZA PËR PËRJASHTIM NGA THIRRJA

Aplikantët do të përjashtohen nga pjesëmarrja në këtë thirrje për propozime nëse ata do të përdorin mjete mashtruese ose do të shkelin rrjedhën normale të iniciativës dhe do të pengojnë procedurat e regjistrimit të aplikantëve të tjerë, manipulojnë funksionimin e Eëbsite ose ndërmarrin aktivitete të tjera që e shkelin këtë rregullore.

Stafi i PoWER-it, ose palët e treta të emëruara nga i njëjti projekt, zotërojnë të drejtën të vazhdojnë, brenda afateve të gjuakuara më të përshtatshme dhe në përputhje me ligjet në fuqi, të kufizojnë dhe pengojnë çdo iniciativë që ka për qëllim shmangien e sistemit të dizajnuar për këtë thirrje. Çdo mashtrim ose tentativë për mashtrim gjatë kësaj nisme do të ndiqet penalisht sipas ligjit dhe do të rezultojë me përjashtimin e aplikantit nga pjesëmarrja menjëherë dhe në mënyrë të pakthyeshme.

NENI 14 - MENAXHIMI I TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

Promovuesi i C4S nuk fiton asnjë të drejtë pronësore për përmbajtjen e paraqitur nga kandidatët. Përmbajtja mbetet pronë e kandidatëve.

Stafi i PoWER mund të publikojë, riprodhojë, përfaqësojë, shkarkimin e çdo përmbajtjeje të paraqitur në thirrjen për propozime, për qëllime të pjesëmarrjes në thirrje, por nuk fiton asnjë të drejtë pronësore në përmbajtje. Nga ana tjetër, kandidati është i informuar se, duke pasur parasysh karakteristikat e Internetit, përmbajtjet e transmetuara nuk mbrohen nga rreziqet e përhapjes dhe / ose përdorimit të mëtejshëm, nga të cilat stafi i PoWER nuk mund të konsiderohet përgjegjës.

NENI 15 - PRIVATËSIA DHE KONFIDENCIALITETI

Të dhënat personale të mbledhura brenda ftesës për propozime të PoWER C4S do të përpunohen në përputhje me dispozitat e Politikave të Privatësisë që pjesëmarrësi pranon në kohën e dorëzimit të aplikacionit.

Me dorëzimin e kërkesës, kandidati lëshon autorizimin më të gjerë të mundshëm për përpunimin e të dhënave personale në pajtim me nenin 6 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/201, për mbledhjen, përdorimin dhe transferimin e tyre.

Nëse Stafi PoWER vendos të ndryshojë thelbësisht thelbin e politikës së privatësisë, Stafi PoWER do t'i publikojë këto ndryshime nëpërmjet një njoftimi në faqen e internetit të projektit.

Kur të plotësohet formulari i aplikimit, kandidati do t'i kërkojë të konfirmojë pranimin e pëlqimit për përpunimin e të dhënave dhe formularin e lëshimit për publikimin dhe shpërndarjen e imazheve, videove dhe prezantimeve të idesë në hapësira publike të ofruara nga projekti PoWER dhe nga partnerët e projektit. Kandidati do t'i kërkojë gjithashtu leje për mundësinë e transferimit të të dhënave të tij tek partnerët e iniciativës për komunikim ose shpërndarjen e propozimeve të tyre tek bizneset

Partnerëve nuk do t'u jepet mundësia për t'i transferuar këto të dhëna palëve të treta.

NENI 16 - PËRMBAJTJA DHE SHENJAT

Kandidatët pranojnë se logot ose përmbajtja e tyre mund të publikohen në faqen e internetit të projektit ose në materialet e promovimit të projektit dhe se ata do të mbajnë të gjitha të drejtat ekskluzive mbi ta. Kandidatët marrin përsipër të mos heqin në asnjë mënyrë projektin e përmbajtjes së internetit dhe mjetet e komunikimit të projektit, duke përfshirë shenjat dalluese të PoWER dhe partnerëve të projektit.

NENI 17 - LIGJI DHE JURIDIKSIONI

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në interpretimin dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje, do të zbatohet vetëm legjislacioni i Republikës së Shqipërisë. Gjykata kompetente do të jetë Gjykata e rrethit Tiranë .